



Koncepti i Zhvillimit Rajonal

Qarku Lezhë
Qershor 2010

gtz



KËSHILLI I QARKUT
LEZHË

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	3
METODOLOGJIA	4
QARKU LEZHË	6
1 PREZANTIM I QARKUT LEZHË	6
2 PËRMBLEDHJE E ANALIZËS PËR QARKUN LEZHË	8
VIZIONI, OBJEKTIVAT, PRIORITETET	12
3 VIZIONI	12
OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE INDIKATORËT PËRKATËS	13
MASAT ZBATUESE DHE KUADRI KOHOR	16
4 MASAT ZBATUESE, KUADRI KOHOR DHE NDËRHRYJET KONKRETE	16
ARDHMËRIA	24
SHTOJCA	27
SHTOJCA I. LISTA E DOKUMENTEVE DHE PLANEVE STRATEGJIKE	27
SHTOJCA II. OBJEKTIVAT, MASAT ZBATUESE, INSTITUCIONET PERGJEGJESE DHE KOSTOT	28

PËRMBLEDHJE

Zhvillimi rajonal përbën një nga iniciativat thelbësore zhvillimore që ndihmon formëzimin e planifikimit sektorial në një kuadër të përgjithshëm politike zhvillimi. Qarku Lezhë tashmë e ka përfunduar këtë iniciativë. Ne kemi zhvilluar konceptin e parë të zhvillimit rajonal, çka shënon hapin e parë në planet e ardhshme mbi zhvillimin rajonal që do të përgatiten më vonë.

Është e qartë se ne duam të shndërrohemi në një rajon tërheqës për biznesin dhe investimet e huaja; duam të njihemi për dinamizmin e zinxhirit të ofertës së agrobiznesit dhe të zhvillimit të shpejtë infrastrukturor. Dihet se zhvillimi i turizmit ofron mundësi nëse është i bazuar në burimet tona natyrore dhe trashëgiminë historiko e kulturore. Burimet njerëzore dhe një administratë e përgatitur dhe e aftësuar me kapacitete të qëndrueshme do të na ndihmojnë t'ia arrijmë qëllimit.

Hartimit i këtij dokumenti ka për qëllim që:

1. Qytetarët të kenë akses tek shërbimet publike në arsim dhe kulturë duke zgjeruar shërbimet dhe infrastrukturën në të gjitha zonat e rajonit dhe për grupe të ndryshme sociale;
2. Zhvillimi i biznesit të mbështetet nëpërmjet organizimit dhe promovimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të iniciativave të ndryshme rajonale dhe kombëtare;
3. Agrobiznesi të zhvillohet nëpërmjet lidhjes dhe afrimit të kapaciteteve më të mëdha industriale;
4. Infrastruktura për banim të zhvillohet;
5. Të konsolidohet një marrëdhënie pozitive, e hapur dhe ndihmuese për komunitetin e banorëve të qarkut.

Koncepti i Zhvillimit Rajonal është dokumenti që nënvizon vizionin, synimet dhe parashtron rrugët që do të ndiqen për t'i përmbyshur ato. Këshilli i Qarkut, i vetëm nuk mund të sjellë progres, nuk mund të jetë një faktor zhvillues, nuk mund të na detyroje nëse nuk jemi të gjithë të motivuar ta bëjmë këtë. Kjo është arsyeja përse ne kemi nevojë për ju. Çdokush dhe secili prej jush duhet ta ndihmojë këtë rajon të bëhet ai që mundet dhe që do të bëhet. Këshilli i Qarkut do të ndihmojë komunitetet lokale dhe aktorë të tjerë të zhvillimit rajonal nga të gjithë sektorët të gjejnë zgjidhjet, të hartojnë projekte dhe do të ndihmojë në gjetjen e fondeve për zbatimin e ideve.

Relevanca, fizibiliteti dhe qëndrueshmëria do të jenë pikat e para dhe përmblylëse të komunikimit. Ne do të mbështesim të gjithë në zhvillimin e projekteve që përputhen me objektivat e rajonit, të cilat janë hartuar për të ndikuar në zhvillimin e tij. Për shkak të mungesës së fondeve, qëndrueshmëria do të duhet të jetë jo e vetmja, por një nga çështjet më të rëndësishme të vlerësimit të cilësisë.

Ne mundemi dhe do t'ia dalim mbanë. Ky është plani sipas të cilit do të realizojmë qëllimin tonë. Në të ardhmen do të organizojmë një seri takimesh, seminaresh dhe workshopesh për përgatitjen e projekteve. Bashkohuni me ne! Ndihmesa juaj për të përmirësuar jetesën tonë do të jetë një punë serioze, e cila do të na japë kënaqësi. Ne mundemi t'i bashkojmë në një – kënaqësinë dhe punën – dhe kjo do të jetë ajo çka do t'i tregojmë gjithëve

METODOLOGJIA

Këshilli i Qarkut të Lezhës, i mbështetur nga Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GTZ) GmbH, ka bërë përpjekje të mëdha gjatë disa viteve për përpunimin e Konceptit të tanishëm të Zhvillimit Rajonal, i cili ka do të shërbeje si dokumenti kryesor strategjik për periudhën 2010-2015. Në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal të Qeverisë Shqiptare të vitit 2007, përpunimi i Konceptit të Zhvillimit Rajonal ka përfshirë pjesëmarrje të lartë dhe konsultime të gjera me një larmi të madhe të palëve të interesuara. Procesi i punës është bazuar në mbledhjen e dokumenteve të tjera strategjike të rajonit, duke filluar nga ato në nivel bashkiak deri në nivelin ndërkuftar. Ekspertizë shtesë është siguruar nga ekspertë ndërkombëtarë nga Gjermania dhe Sllovenia. I gjithë procesi është drejtuar në mënyrë paralele dhe me bashkëpjesëmarrje / bashkëpunim me qarkun e Shkodrës. Për Lezhën e gjithë puna është organizuar nga administrata e Këshillit të Qarkut të Lezhës.

Mbledhja e dokumenteve strategjike ekzistuese

Një numër dokumentesh strategjike ishin tashmë të gatshme në rajon – nga zhvillimi planeve bashkiake deri tek shumë i hollësishmi “Plani Rajonal Shkodër-Lezhë 2005-10” (i njohur si plani EPTISA). Përmbledhja e të gjithë këtyre dokumenteve u krye në fillim të procesit dhe u botua një broshurë që përmban përmbledhje të secilit prej dokumenteve strategjike, duke u bërë e përdorshme për të gjitha palët e interesuara. Në këtë mënyrë ata mundën të përdorin njohuritë ekzistuese si një bazë për diskutimet e tyre. Prandaj, Koncepti për Zhvillimin Rajonal nuk pretendon të fillojë gjithçka nga e para, por të mbledhë së bashku të gjitha idetë e mëparshme nën një kuadër të përbashkët të modeluar nga palët e interesuara.

Organizimi i pjesëmarrjes së palëve të interesuara

Gjatë vitit 2009, një seri workshopesh është zhvilluar nën moderimin e një eksperti ndërkombëtar dhe moderatorëve që vinin nga administrata e Qarkut, të trajnuar nga GTZ. I nisur gjatë një aktiviteti publik në prill 2009, procesi ishte i hapur për të gjitha palët e interesuara të Qarkut. Pjesëmarrësit nga shoqëria civile dhe sektori privat ishin të ftuar për të marrë pjesë së bashku me përfaqësuesit e administratës së Qarkut dhe të komunave e bashkive. Në këtë mënyrë u bë i mundur shfrytëzimi i njohurive lokale, ekspertizës sektoriale dhe i interesave të banorëve.



Diskusimet për pikat e forta dhe të dobëta të Qarkut u zhvilluan me grupe pune për tematikat e mëposhtme:

- Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura
- Arsimi, shëndetësia, kultura dhe çështjet sociale
- Turizmi, agrobiznesi, peshkimi, pyjet
- Energjia alternative dhe mjedisi

Në vijim, palët e interesuara të pranishme në workshope zhvilluan vizionin udhëheqës, vunë në përparësi objektivat dhe idetë për projekte, duke përfshirë mundësitë për veprime ndërkufitare dhe bashkëpunimin me Këshillin e Qarkut të Shkodrës.

Përfundimi dhe miratimi zyrtar

Administrata e Këshillit të Qarkut, e përbërë nga një “grup bërthamë”, i kryesuar nga drejtorja e Zyrës së Programim-Zhvillimit, ishte përgjegjëse për hartimin e Konceptit të Zhvillimit Rajonal, duke përfshirë masat e rishikuara, afatet kohore dhe vlerësimin e kostove financiare. Në këtë proces u mbajtën konsultime për të siguruar të dhëna nga ekspertët e rajonit. Komentet përfundimtare janë mbledhur gjatë një aktiviteti publik të organizuar së bashku me Qarkun Shkodër. Koncepti i Zhvillimit Rajonal u aprovua ne 17 Shtator , 2010, nga Këshilli i Qarkut Lezhë .

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi




Gjatë zhvillimit të workshopeve numri i pjesëmarrësve ka qenë rreth 15-25 vetë. Ka qenë e vështirë të arrihej pjesëmarrja sipas raportit të menduar 1/3 - 1/3 - 1/3 për sektorin publik, sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Veçanërisht pjesëmarrja nga përfaqësuesit e sektorit privat mund të kishte qenë më e lartë, por ky lloj dialogu mes sektorëve publikë-privatë është krejtësisht i ri dhe bizneset nuk e kanë ende të qartë se çfarë përfitimesh mund të ketë komuniteti i biznesit nga ky proces.

Ndërkohë, pjesëmarrja e grave ka qenë e kënaqshme gjatë gjithë procesit.

Të rinjtë u ftuan të japin idetë e tyre në një workshop të veçantë, nga i cili u morën të dhëna shumë të vlefshme. Një përparësi tjetër e këtij procesi ishte pjesëmarrja e aktorëve të interesuar nga njësitë e ndryshme lokale, siç mund të përmendim Rrëshenin, Laçin, Fushë-kuqen Mamurrasit.



QARKU LEZHË

1 Prezantim i Qarkut Lezhë

I vendosur në veri-perëndim të Shqipërisë, Qarku Lezhë përbëhet nga pesë bashki dhe 16 komuna, me 9 qytete dhe 170 fshatra, me një popullsi prej 216.006 banorë. Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe prej 1588.4 km² dhe kufizohet me Qarkun Shkodër në veri, qarqet Kukës dhe Dibër në verilindje, lindje dhe juglindje, qarkun e Durrësit në jug dhe shtrihet përgjatë bregdetit të Adriatikut në perëndim me një vijë bregdetare prej 38 km. Territori i Lezhës përbëhet nga një zonë malore në lindje (65%) dhe zona fushore në perëndim (35%). Shumica e popullsisë jeton në zonat rurale (rreth 60%), ndërsa 40% jetojnë në qendrat urbane.

Qarku Lezhë

Popullsia: 216.006 banorë
Rrethet: Lezhë, Kurbin e Mirditë
Qendër qarku: Lezha



Pozicioni gjeografik i Qarkut Lezhë – në qendër të arterieve kryesore të transportit që lidhin veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin në rrugë tokësore, si edhe afërsia e tij me portet kryesore detare si ai i Durrësit dhe i Shëngjinit (ky i fundit, pjesë e territorit të qarkut), e bën këtë rajon një zonë mjaft tërheqëse dhe lehtësisht të arritshme jo vetëm në plan kombëtar, por edhe për fqinjët, si: Italia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe Greqia. Një element shtesë mjaft të rëndësishëm për potencialet zhvillimore të qarkut përbëjnë edhe burimet e shumta të ujit të pijshëm, lidhjet hekurudhore që shtrihen deri në Malin e Zi, transportin ajror duke pasur parasysh afërsinë me aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza” dhe aeroportin e Gjadrit, i cili ende nuk është funksional.

Qarku Lezhë është një nga rajonet me një potencial strategjik mjaft të rëndësishëm, vlera natyrore e historike të çmuara, me

zona arkeologjike, objekte kulturi, monumente të kulturës dhe vlera historike kombëtare.¹ Këto burime janë të vendosura në një territor me natyrë të larmishme – me burime të pasura ujore, lumenjve (Drin, Gjadër, Fan i madh, Fan i vogël, Drojë, Urakë e Mat), pranë detit Adriatik, maleve e kodrave, me një florë dhe faunë mjaft të pasur – çka i shton interesit ekonomik edhe potencialin turistik për qytetarët shqiptarë dhe të huaj. Ky potencial është veçanërisht i

¹ Qendra administrative e Qarkut, qyteti i Lezhës, daton që në vitin 385 para Krishtit dhe përmban vlera të rëndësishme historike dhe kulturore (përfshirë varrin e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Kështjellën e Lezhës, etj.)

rëndësishëm për këtë rajon dhe njëherësh tërheqës për investitorët dhe pushuesit, duke pasur parasysh se brenda një rrezeje relativisht të vogël, qarku ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit detar / bregdetar, kulturor, malor, agroturizmin etj.

Qarku i Lezhës ka qenë një zonë me ekonomi kryesisht industriale (miniera, industri ushqimore, kimike) dhe bujqësore deri në fillim të viteve 1990. Me fillimin e proceseve demokratike dhe transformuese politike, sociale dhe ekonomike, Qarku i Lezhës filloi të përballlet me sfida të mëdha nga pikëpamja e transformimit drejt një ekonomie të hapur tregu, e cila në ditët e sotme është e përqendruar kryesisht në industrinë e materialeve dhe aktiviteteteve të ndërtimit, bujqësi dhe peshkim. Pavarësisht progresit dhe zhvillimit, Qarku i Lezhës ka aktualisht një nivel relativisht të lartë papunësie prej rreth 24.2%, rreth 10.7% më shumë se niveli mesatar i papunësisë në shkallë kombëtare. Nga ana tjetër, 56.6% e të punësuarve janë në sektorin privat, ndërsa 43.4% në atë publik (shtetëror) çka nxjerr në pah nivelin ende jo të kënaqshëm të zhvillimit të sektorit privat kundrejt rëndësisë që merr sektori publik si një burim të ardhurash për familjet.²

Në territorin e qarkut operojnë rreth 2.978 kompani private, nga të cilat thuhet se 85% janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM). Duke pasur parasysh nivelet aktuale të mundësive për punësim të ofruara nga sektori privat, si edhe tendencat e pritshme të zhvillimit në fusha e sektorë të ndryshëm, si industria përpunuese, turizmi apo shërbimet për kompanitë private, është e rëndësishme të nxirret në pah pikërisht potenciali për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik i Qarkut të Lezhës. Kjo është thelbësore në kontekstin aktual të reformave për të përmirësuar mjedisin e biznesit nëpërmjet lehtësimit të procedurave të liçensimit dhe regjistrimit (one stop shop), thithjes së investimeve të huaja direkte në sektorët e energjetikës, industrisë (krijimi i parkut industrial), turizmit apo shërbimeve dhe aktiviteteteve të tjera ekonomike që mbështeten tek potenciali i shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe të avantazheve të tjera.

Krahas partneriteteve me aktorë kombëtarë e rajonalë, adresimi i sfidave të zhvillimit social-ekonomik dhe jo vetëm për rajonin e Lezhës, imponon pashmangshmërisht konsolidimin e bashkëpunimit, para së gjithash me aktorët relevantë të zhvillimit në qark, por gjithashtu edhe me partnerë në qarqet fqinje me të cilat Lezha ndan problematika, avantazhe dhe mundësi të përbashkëta. Qarku i Shkodrës është në këtë kontekst një nga rajonet me të cilat Lezha ka qenë dhe mbetet tradicionalisht e lidhur. Kjo marrëdhënie bashkëpunimi, mbase deri diku edhe preferenciale krahasuar me qarqet e tjera, duhet të konceptohet si një partneritet mes dy rajonesh, të cilët jo vetëm ndajnë problematika dhe mundësi të përbashkëta, por janë gjithashtu komplementarë në sektorë të ndryshëm. Kështu, të dy qarqet janë të njohur për vlerat dhe monumentet historike e kulturore, me burime të rëndësishme natyrore, me një potencial të konsiderueshëm zhvillimi ekonomik dhe pika thelbësore komunikimi me fqinjët veriorë (Mali i Zi) dhe verilindorë (Kosova) të cilat mund të konsiderohen si potenciale strategjike për të gjithë vendin. Nga ana tjetër, komplementariteti mes tyre vërehet në nën-degë të ndryshme të sektorëve prioritarë për të dy rajonet si turizmi, bujqësia dhe peshkimi, shërbimet etj.

² Të dhëna nga Instituti i Statistikës (2009). Shih www.instat.gov.al

2 Përmbledhje e analizës për Qarkun Lezhë

Koncepti i zhvillimit rajonal të Qarkut Lezhë bazohet thellësisht dhe udhëhiqet nga një përfaqëse gjithëpërfshirëse e cila i konsideron problematikat aktuale dhe sfidat për të ardhmen nën një kontekst shumë-sektorial dhe me komponente me zhvillime dhe impakt të ndërlikuar. Analiza e situatës aktuale dhe e sfidave për një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të Qarkut merr parasysh ndër të tjera edhe mesazhet kryesore të përcjella në kuadrin e procesit të konsultimeve me aktorë dhe partnerë rajonalë.

Ky proces gjithëpërfshirës i udhëhequr nga Këshilli i Qarkut identifikoi sektorët e mëposhtëm prioritarë, tek të cilët aktualisht janë përqendruar jo vetëm aktivitetet kryesore ekonomike, sociale etj, por edhe pritshmëritë e qytetarëve të rajonit dhe potencialet më të rëndësishme të tij në funksion të zhvillimit të harmonizuar social-ekonomik:

❖ Zhvillimi ekonomik, infrastruktura dhe planifikimi hapësinor

Reformat në sistemin e liçencimit në përputhje me nevojat e komunitetit, klima e mirë për të thithur investime të huaja, përfundimi i plotë i procesit të privatizimit, ngritja e parqeve industriale etj., shihen si pika të forta në rritjen e ekonomisë lokale. Përdorimi racional i burimeve natyrore dhe trajtimi i industrisë minerare, standardizimi, çertifikimi, akreditimi i mallrave, krijimi i “*branding*” rajonal duhet të shihen me shumë prioritet në të ardhmen. Sektorët kyç për zhvillimin e ekonomisë së rajonit janë: Agrobiznesi, pylltaria dhe prodhimet e drurit, peshkimi, turizmi malor e bregdetar, industria e lehtë e minerare, si dhe shërbimet për kompanitë.

Zhvillimi i qëndrueshëm i rajonit bazohet në vlerësimin e potencialeve të kapitalit (njerëzor, natyror, institucional etj.) dhe mbi mundësitë për t'i zhvilluar ato në mënyrë që të fitohet terren konkurrues me rajonet e tjera. Rajoni i Lezhës dhe i Shkodrës kanë fatin të kenë një plan rajonal hapësinor të hartuar me ekspertizën e “EPTISA International Group”, i cili i referohet metodave që do të përdoren nga sektori publik për të ndikuar në shpërndarjen e aktiviteteve në hapësirë për një periudhë 20-vjeçare. Ky dokument po shërben si bazë për hartimin planeve urbane dhe masterplaneve të zhvillimit të zonës. E domosdoshme është që bazuar në planin e EPTISA-s dhe ELPA-s, të hartohen plane urbanistike strategjike për të gjithë rajonin. Hartimi i masterplaneve në fushën e turizmit dhe energjisë alternative janë të domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm.

❖ Turizmi, agrobiznesi, pyjet dhe peshkimi

Siç u përmend edhe më sipër, pozita gjeografike e rajonit, flora dhe fauna, klima dhe relievi i pasur me burime të mëdha natyrore ofrojnë kushte përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, agrobiznesit, turizmit, aktiviteteve të tjera ekonomike të lidhura me pyjet, peshkimin etj. Nga ana tjetër, po aq të konsiderueshme mbeten problematikat dhe sfidat që duhen adresuar në secilin prej sektorëve, duke filluar nga ndërhyrjet e dëmshme në ekosistem, erozioni, mungesa e investimeve infrastrukturore për të mundësuar zgjerimin e agrobiznesit, promovimin e markave rajonale, nxitjen e industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore dhe të peshkimit, shfrytëzimi i pozitës së qarkut dhe lidhjeve tokësore, e ujore, etj në funksion të zhvillimit ekonomik dhe sidomos të turizmit; nxitja e investimeve të huaja dhe shfrytëzimi i kapitalit të brendshëm për këtë sektorë në përputhje me nevojat dhe sfidat ekonomike, sociale, mjedisore etj.

❖ Mjedisi dhe energjetika

Zbatimi i politikave efikase ekonomike, sociale dhe mjedisore është mënyra më e mirë për të arritur progres në fushën e mjedisit, pasi burimet ekonomike, komuniteti qytetar dhe mjedisi ku ata ndërveprojnë janë aset i rëndësishëm i çdo forme të organizuar social-ekonomiko-politike. Qarku i Lezhës trashëgon një pasuri të rëndësishme natyrore. Përmirësimet e legjislacionit, vendosja e standardeve dhe e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e mjedisit, hartimi i planeve të veprimit në mjedis në disa njësi vendore, roli i shoqërisë civile sidomos në rritjen e ndërgjegjësimit publik etj., po ofrojnë më shumë garanci për një zhvillim të qëndrueshëm në këtë sektor. Nga ana tjetër, vlen të theksohet se trashëgimia e mbetjeve të rrezikshme nga aktiviteti industrial i para viteve '90, "hotspotet", administrimi i papërshtatshëm i mbetjeve, keqpërdorimi i tokës bujqësore, zhvillimi kaotik urban, prerjet në pyje, erozioni i lartë i tokës, mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore, varfërimi i pasurive ihtike, degradimi i zonave të mbrojtura natyrore e varfërimi i biodiversitetit, ulja e cilësisë së ajrit në zonat urbane, janë ndër problematikat kryesore mjedisore me të cilat përballet Qarku i Lezhës. Faktorë të tjerë të cilët duhet të merren seriozisht në konsideratë janë forcimi i kapaciteteve institucionale, përvojës, asistencës teknike e financiare për t'ë zbutur, përballur apo përfituar nga pasojat e ndryshimeve klimatike, mjaft evidente në qarkun e Lezhës. Harmonizimi i ndërhyrjeve në mbrojtje të mjedisit me nevojat për një zhvillim ekonomik-social mbetet në thelb të çdo përjasje ndaj problematikës.

Duke qenë i pasur me burime hidrike, dhe me një pozitë e reliev të favorshëm për të shfrytëzuar mundësitë në kuadër të sektorit energjetik, rajoni i Lezhës përbën një zonë mjaft tërheqëse për investime në këtë fushë. Aktualisht, energjia e rinovueshme qëndron në krye të prioriteteve të vendit, ndërkohë që Qarku i Lezhës shihet gjithashtu si një prej zonave më të përshtatshme për zhvillime me ndikim të qëndrueshëm. Duke qenë më pranë nevojave dhe problematikës së komuniteteve vendore, partnerët dhe aktorët rajonalë mund dhe duhet të përfshihen në mënyrë aktive duke sjellë jo vetëm perspektivën e komunitetit dhe të ardhmes së rajonit, por gjithashtu duke ofruar kontributin e vet në këto procese.

❖ Arsimi dhe Kultura

I vështruar në rrafshin historik, Qarku i Lezhës është trualli i shkollave të para shqipe që në shekullin XVII. Historia e vërtetë e arsimit fillon në këtë oaz arsimdashës në Kurbin, Pllanë, Blinisht, Velë, dhe me vonë në Troshan, etj.. Ndryshimet në planin ekonomik-social, lëvizjet demografike dhe mungesa e vëmendjes së duhur në infrastrukturën e sektorit dhe në përgjithësi në nivelin e mësimdhënies, kanë ndikuar ndjeshëm në cilësinë e shkollimit gjatë tranzicionit. Sfidat në këtë kuptim kanë të bëjnë jo vetëm me investimet infrastrukturore, por gjithashtu me hartimin e një strategjie të arsimit dhe të formimit profesional që t'i përgjigjet dhe nevojave të tregut rajonal.

Rajoni i Lezhës njihet gjithashtu edhe për pasuritë dhe vlerat kulturore e historike, të cilat përbëjnë një potencial të rëndësishëm nxitës për sektorë dhe aspekte të tjera të jetës social-ekonomike. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre si vlera historike të një kombi, vlen të theksohet se vëmendja e kushtuar deri tani ka mjaft hapësirë për përmirësim.

❖ Shëndetësia dhe Çështjet sociale

Identifikimi dhe analiza e situatës, jo vetëm nëpërmjet të dhënave statistikore, por edhe nëpërmjet workshopeve, tregon se rajoni ka një shpërndarje racionale të objekteve të sistemit spitalor dhe të shëndetit publik. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, infrastrukturës, lufta kundër korrupsionit në shëndetësi, shtrirja e shërbimit farmaceutik në zonat rurale etj, janë disa prej sfidave në këtë fushë.

Lëvizjet e brendshme demografike, si edhe fenomenet shoqëruese të tranzicionit (varfëria, problemet sociale për grupmosha e kategori të caktuara, etj.), kanë ndikuar ndjeshëm në fushën e çështjeve sociale, ndërkohë që kanë zhvendosur vëmendjen nga krijimi i kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme për një jetë sociale sa më të mirë. Në këtë kontekst, mbështetja dhe krijimi i qendrave që ofrojnë shërbime socio-edukative për të rinjtë dhe kategori të tjera përbën një nga alternativat e zhvillimit të sektorit, për të cilin mbeten thelbësore cilësia dhe shtrirja e shërbimeve.

❖ **Qeverisja e orientuar drejt qytetarit dhe konteksti i partneriteteve dhe bashkëpunimit brenda dhe ndër-rajonal**

Prioriteti i fundit, por sigurisht jo për nga rëndësia, ka të bëjë me rolin e aktorëve publikë rajonalë – Këshilli i Qarkut dhe autoritetet vendore – marrëdhënien e tyre me komunitetin, aktorët e rëndësishëm rajonalë, partnerët në rajonet fqinje dhe roli si lider i politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Një numër i konsiderueshëm programesh të asistencës për qeverisjen vendore kanë vendosur në qendër të mbështetjes së tyre pikërisht këto ndërveprime dhe praktika të qeverisjes së mirë, të cilat konsiderohen në vizionin e Këshillit të Qarkut si thelbësore për rezultate të qëndrueshme. Ndonëse të kushtëzuar nga sfidat më imediate të brendshme gjatë pjesës më të madhe të tranzicionit, në vitet e fundit vihet re një ndjeshmëri më e lartë ndaj kapaciteteve të të gjithë aktorëve për të siguruar një sistem mirëqeverisjeje të orientuar drejt komuniteteve dhe sfidave social-ekonomike të tyre. Ndarja e përgjegjësisve, përpjekjeve dhe e resurseve në funksion të tyre, nën një përqsasje gjithëpërfshirëse, e cila mbështetet tek një mori ndërveprimesh mes aktorëve brenda dhe jashtë rajonit, përbën një komponent të cilit do t'i kushtohet vëmendje në vazhdimësi.

Te rinjte dhe prespektivat e tyre per zhvillimin

Vizioni 2020

Prioritetet dhe perspektiva zhvillimore e rajoneve të Lezhës dhe Shkodrës u vendosën në fokusin e diskutimeve të përfaqësuesve të të rinjve të të dy qarqeve në kuadër të një workshop-i rajonal. Në vizionin e gjeneratës së re – studentë, aktivitet të organizatave rinore etj – rajonet e Shkodrës dhe Lezhës shihen si pjesë e familjes europiane brenda 10-vjeçarit të ardhshëm, me një zhvillim të qëndrueshëm, mirefunksionim të institucioneve dhe bashkëpunim të konsoliduar.

Një fjali për të përshkruar

QARKUN sipas të rinjve...

Njësi administrative dhe territorial, me potenciale të mëdha zhvillimi në fushën e turizmit, bujqësisë dhe energjitikës...POR me shfrytëzim minimal dhe keqmenaxhim të tyre.

Problemet e qarkut

Disa prej problemeve thelbësore të identifikuar do të përfshinin: mungesa e qendrave rinore, infrastruktura e dobët, marketing i dobët, mosndërgjegjesim i qytetarëve, mosaktivizim i rinisë në dhënien e ideve, mungesë e njerëzve të specializuar në administratë, mungesë e metodave motivuese në mësimdhënie, mungesë e aktiviteteve kulturore, programe mësimore të mbingarkuara, mosshfrytëzimi i duhur i burimeve natyrore, kaos urban, keqmenaxhimi i fondeve publike, ndotja e mjedisit, mosshfrytëzimi i zones industriale, mungesë e politikave afatgjatë, mungesë planifikimi, mungesë bashkëpunimi, infrastrukturë e dobët në shkolla, shpyllezimi.

Zgjidhja e problemeve:

Në kontekstin e një plan-veprimi të integruar me politikat lokale e rajonale, disa prej projekt-ideve, të cilat të rinjtë do të donin t'i shihnin të integruara janë:

- Vendosija e ndriçimit, sinjalistikës dhe kanalizimeve
- Përdorimi i metodave bashkëkohore.
- Projekte të përbashkëta të bashkisë me rininë.
- Shkolla verore. Krijimi i qendrave rinore.
- Promovimi i zonave turistike përmes broshurave, postera, site në internet.
- Sensibilizimi i opinionit publik, vendosja e koshave dhe percaktimi i vendgrumbullimeve.
- Testimi, trajnimi dhe përzgjedhja sipas aftësive
- Nxitja politike për rikonstrukcionin e zonës industrial, mirëmbajtja e pyjeve dhe shtimi i tyre
- Komunikimi dhe transparenca me komunitetin për projekte të ndryshme

Si të shfrytëzojmë pikat e forta

- Planifikim afatgjatë i pasurive natyrore dhe Pjesëmarrja e aktorëve kryesore në planifikim
- Ruajtja e pasurive natyrore, ndalimi i shfrytëzimit pa kriter
- Bashkëpunimi mes operatorëve
- Mbështetje e sportit nga institucionet kompetente dhe Krijimi i akademive sportive.
- Konkurse kulturore ndërmjet shkollave.
- Organizim i panairove.
- Krijimi i kushteve për të ushtruar sportet në natyrë, p.sh ski dhe patinazh.
- Promovimi i vlearve kulturore dhe natyrore.
- Nxitja e investimeve.
- Mirëmanaxhimi i burimeve njerezore.
- Mbështetja e prodhimeve vendase.

Rajonet Shkodër dhe Lezhë

PIKAT E FORTA

Trashegimia natyrore dhe kulturore, sporti, turizmi, kapacitetet njerezore, ekonomia, burime minerare dhe energjetike, rini aktive, tradita, industria, transporti, vitaliteti, klima mesdhetare

VIZIONI, OBJEKTIVAT, PRIORITETET

3 Vizioni

Gjithëpërfshirja (aktorë & sektorë) dhe prioritarizimi (bazuar në burime & mundësi) kanë qenë dy prej elementëve thelbësorë për hartimin e një strategjie të qartë, reale dhe të matshme për Qarkun e Lezhës. Në këtë kuptim, kontributi i aktorëve relevantë dhe pritshmëritë e tyre realiste të shprehura gjatë konsultimeve për përgatitjen e konceptit të zhvillimit rajonal të Qarkut përbëjnë shtyllat kryesore që kanë formëzuar vizionin tonë për Qarkun e Lezhës. Dinamika e procesit të zbatimit të këtij koncepti do të vazhdojë të udhëhiqet nga e njëjta përfaqëse përfshirëse dhe e qëndrueshme.

Vizioni :

Qarku i Lezhës, tërheqës për aktivitetet e biznesit dhe investimet e huaja, nje mjedis i favorshëm për të koordinuar me qarqet e tjera ne Veriun e Shqipërisë, në gjendje të menaxhojë burimet njerëzore e natyrore.

Qarku i Lezhës, me një dinamikë intensive në zinxhirin e furnizimit bujqësor dhe zhvillimin e shpejtë të infrastrukturës mbështetëse të biznesit, rritjen e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e turizmit të harmonizuar.

Administrata e vendore e Qarkut të Lezhës zotëron aftësi menaxhuese për të promovuar risi në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

4 Objektivat, prioritetet dhe indikatorët përkatës

Bazuar në vizionin e Qarkut në lidhje me kontekstin e synuar social-ekonomik të rajonit të Lezhës, Koncepti i Zhvillimit Rajonal të Lezhës dhe procesi i konsultimeve gjithëpërfshirëse që i paraprinë dokumentit udhëhiqet nga një përjasje sa realiste, aq edhe ambicioze në përcaktimin e objektivave të zhvillimit, në respekt të sfidave më prioritare që kushtëzojnë një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik. Një përjasje e tillë ka nxitur dhe udhëhequr gjithashtu edhe hartimin e kuadrit të masave zbatuese të Konceptit në një periudhë afatmesme, por jo vetëm, duke u kushtëzuar, jo vetëm nga sfidat imediate, por gjithashtu edhe nga vizioni afatgjatë për Qarkun. Monitorimi i progresit dhe vlerësimi i ndikimit dhe përpjekjeve gjithëpërfshirëse në përmbushjen e objektivave të përcaktuara mbetet një nga elementet kryesore dhe mjaft të rëndësishme, veçanërisht për të siguruar një proces zbatimi realist, të matshëm dhe fleksibël në përputhje me dinamikën e kushteve dhe me mundësitë e përmirësimit të tij.

Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe me synimin për të iniciuar fazën e parë të zbatimit të Konceptit të Zhvillimit Rajonal, Qarku dhe partnerët e zhvillimit rajonal do të ndjekin objektivat e mëposhtme të zhvillimit dhe menaxhimit rajonal:

1. Shërbime publike cilësore në fushën e arsimit dhe kulturës të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku, prezente në të gjithë territorin e qarkut dhe veçanërisht për grupet e ndryshme sociale

Adresimi i këtij prioriteti në vizionin tonë mbetet thelbësor para së gjithash për cilësinë e jetesës së banorëve të rajonit, për sigurimin e aksesit dhe mundësive të barabarta për të gjitha grupet sociale, por gjithashtu është po aq i rëndësishëm edhe në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimin e potencialit të rajonit në fushën e turizmit. Në funksion të këtij objekti, masat zbatuese dhe përpjekjet gjithëpërfshirëse të partnerëve të zhvillimit rajonal të Qarkut do të fokusohet në arritjen e rezultateve të mëposhtme konkrete, të cilat shërbejnë gjithashtu edhe si indikatorë suksesi dhe objekt monitorimi e vlerësimi për këtë objekt:

- a. Shtrirja, përmirësimi dhe organizimi i shërbimeve sociale në territorin e të gjitha komunave dhe bashkive të Qarkut, të koordinuara gjithashtu me shërbimet e tjera ndihmuese për të asistuar zhvillimet në sektorë të ndërlidhur;
- b. Zhvillimi i sistemit të arsimit dhe programet e trajnimit profesional, të hapura për të gjitha grupet sociale me synimin për të mbërritur në një nivel prej 30% të popullsisë mbi 28 vjeç të përfshirë në disa lloje edukimi;
- c. Mundësitë dhe potenciali i pasurisë kulturore dhe historike të rajonit të Lezhës të promovohen në të paktën dy produkte turistike rajonale të marketuara në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi.

2. Zhvillimi i sektorit privat i mbështetur nga organizimi dhe promovimi i bashkëpunimit të biznesit, si edhe nga koordinimi i faktorëve të ndryshëm nxitës në nivel qarku dhe kombëtar.

Fokusi tek zhvillimi ekonomik dhe një mjedis tërheqës biznesi mbetet në qendër të çdo përpjekje të zhvillimit rajonal. Koncepti i zhvillimit për Qarkun Lezhë gjithashtu e vendos në qendër të prioritetëve të veta konsolidimin e sektorit privat, duke siguruar koordinim jo vetëm për shfrytëzimin, por edhe për konservimin e burimeve natyrore dhe potencialeve të tjera të rajonit. Në këtë kontekst, masat zbatuese për këtë objekt do të synojnë këto rezultate të matshme:

- a. Zonat e bizneseve të përcaktohen dhe të planifikohen në përputhje me kuadrin e plotë ligjor për lejet dhe dokumentacionin planifikues të nevojshëm. Më konkretisht, më shumë se 50% e aktiviteteve industriale do të përqendrohen në zonat e përcaktuara për aktivitetin e operatorëve ekonomikë, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës në zonat e banuara qendrore apo periferike nga impaktet shqetësuese (zhurmat, ndotja etj.);
- b. One stop shop (inkubatorët e biznesit) për zhvillimin e biznesit të vizituar rregullisht nga të paktën 20% e operatorëve privatë në Qark dhe aktiviteti i minimalisht dy kompanive në territorin e Qarkut në vit të marketuara jashtë territorit të rajonit.

3. Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në rrjet me kapacitete më të mëdha industriale

Bujqësia dhe industria e përpunimit të produkteve bujqësore mbeten një nga aktivitetet kryesore të ekonomisë së Qarkut dhe njëherësh faktorë të rëndësishëm të zhvillimit. Sfidat më imediate në kuadër të këtij objekti kanë të bëjnë jo vetëm me kapacitetet aktuale prodhuese dhe përpunuese, por gjithashtu me kapacitetet njerëzore dhe mundësitë e pakta për programe cilësore trajnimi. Më konkretisht, operacionalizimi i këtij objekti do të synojë materializimin e këtyre rezultateve konkrete:

- a. Këshilli i Qarkut do të nxisë iniciativa për organizimin e një produkti / tregu që përfshin të paktën 30 prodhues të vegjël të produkteve bujqësore për t'u marketuar dhe për t'u shitur në tërësi;
- b. Konsolidimi dhe shtrirja e programeve trajnuese profesionale për agrobiznesin, të cilat do të frekuentohen të paktën nga 100 persona në pesë vite. Në kurrikulat e trajnimit duhen përfshirë edhe konceptet e ndryshimeve klimatike, ndikimeve në bujqësi apo sektore të tjera të lidhur me to.
- c. Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura të Qarkut brenda rrjetit përfaqësues nga 1080 ha ose 10.8% e sipërfaqes pyjore të Qarkut të shkojë në 23200 ha ose 25%.

4. Përmirësimi i infrastrukturës si një kusht për përmirësimin e mundësive të jetës social-ekonomike dhe si një faktor nxitës për koordinimin me sektorë të tjerë si ai energjetik

Sigurimi i një infrastrukture cilësore në funksion të standardit të jetesës dhe të zhvillimit të sektorit të biznesit në vizionin e Konceptit të Zhvillimit Rajonal konsiderohet si një nga elementët me ndikim multidimensional që prek komunitetin e banorëve dhe atë të sektorit privat në territorin e Qarkut. Ndër nevojat më imediate në këtë kontekst renditen ato që kanë të bëjnë me infrastrukturën parësore që mundëson një standard të kënaqshëm jetese dhe një mjedis të përshtatshëm për aktivitetet e ndryshme ekonomike. Nga ana tjetër, prioritetet në këtë kontekst do të ndërliken me planet aktuale për shfrytëzimin e potencialit energjetik të rajonit, si një nga sektorët më tërheqës të tij. Fokusi i masave zbatuese për këtë objekt do të drejtohet tek këto rezultate:

- a. Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe shtrirja e ofrimit të këtyre shërbimeve për 70% të popullsisë dhe për jo më pak se 90% të zonës së biznesit në territorin e Qarkut;
- b. Mbështetje për zbatimin e strategjive investuese në energjitikë në territorin e Qarkut për të siguruar mbulimin e 5% të nevojave të Qarkut nga burimet alternative të energjisë;
- c. Përmirësimi i rrugëve të brendshme ekzistuese dhe asfaltimi i të rejave, kryesisht në drejtimet turistike. Në projektimin e ndërtimit të infrastrukturës së re të merren

ne konsiderate dhe ndikimet e ndryshimeve te pritshme te klimes e nivelit te detit.

5. Konsolidimi i një marrëdhënie pozitive, të hapur dhe ndihmuese për komunitetin e banorëve të Qarkut si edhe nxitja e partneriteteve efikase të bashkëpunimit brenda dhe nder-rajonat

Objektivi i fundit, por jo për nga rëndësia, i Konceptit të Zhvillimit Rajonal targeton hallkën mbase më të rëndësishme për një qeverisje të mirë, transparente dhe gjithëpërfshirëse në të gjithë Qarkun e Lezhës. Në respekt të praktikave më të mira për një qeverisje të orientuar drejt qytetarit, si edhe të nevojave të komunitetit për të përmbushur një jetë sociale sa më të larmishme për grupmosha e kategori të ndryshme, Qarku do të përqendrohet në realizimin e këtyre indikatorëve (objekt i monitorimit dhe vlerësimit të suksesit):

- a. Përmirësimi i mundësive argëtuese për grupe të ndryshme sociale të organizuara; të paktën në një qendër multi-funksionale me shërbime të larmishme: biblioteka, salla kompjuterash, hapësira për takime në klube (leximi, muzike, sporti etj.) dhe shoqata;
- b. Qarku do të ketë të paktën tre site natyrore dhe opsione për vizita në natyrë, zona bregdetare dhe akses të lehtësuar tek trashëgimia historiko-kulturore.

Një rëndësi e veçantë në kuadër të masave zbatuese për arritjen e objektivave do t'u kushtohet avantazheve të bashkëpunimit me Qarkun e Shkodrës, duke ndarë përgjegjësitë dhe resurset për të siguruar një zhvillim rajonal të qëndrueshëm dhe shumëplanësh.

|

Shembuj projektsh:

- Restaurimi i kalasë së Lezhës dhe rikonstruksioni i rrugës për në kala
- Ndërtimi i muzeut rajonal etnografik
- Rikonstruksioni i muzeut të Mirditës
- Zyrë e informacionit turistik

5.2.4. Qendra rajonale e rrjetezimit (*networking*)

Një nga elementët kryesorë të zhvillimit social është padyshim edhe niveli i shërbimeve dhe mundësive të ofruara në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave për kohë cilësore social-kulturore, jo vetëm të rezidentëve, por gjithashtu edhe të vizitorëve të rajonit. Për këtë qëllim masa zbatuese synon përmirësimin e “ofertës” së shërbimeve në qendra kulturore multi-funksionale.

Afati kohor	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016	
Masat	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
4. Qendra 'Networking' rajonale																										
4.1. Kuptimi i mundësive për hapjen e qendrave kulturore në rajon																										
4.2. Përgatitja e përmbajtjes së qendrave kulturore																										
4.3. Aplikimi për financim në fondet kombëtare																										
4.4. Zbatimi i projekteve																										
4.5. Vlerësimi i rezultateve dhe impakteve																										

Shembuj projektsh:

- Ndërtimi i qendrave multifunksionale në qytete
- Blerje e paisjeve për qendrat shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale

5.3. Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura

Duke qenë objekt i përgjegjësisë dhe fokusit të më shumë aktorëve, zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura e nevojshme që mundëson operimin efikas të biznesit përbën një nga ndërhyrjet më të rëndësishme, e cila kërkon mirë-koordinim me të gjithë aktorët institucionalë. Nga ana tjetër, duke qenë të vetëdijshëm për kapacitetet aktuale në këtë drejtim, parashikohet zbatimi i dy ndërhyrjeve kryesore si më poshtë:

5.3.1. Përcaktimi i zonave të biznesit dhe infrastrukturës përkatëse

Ndërhyrja konkrete në këtë drejtim ka ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm tek sektori i biznesit, i cili tashmë do të ketë të përqendruar të gjithë rrjetin e shërbimeve mbështetëse, por gjithashtu edhe tek komuniteti i qytetarëve dhe mjedisi. Zbatimi i kësaj sipërmarrje do të kërkojë në vazhdimësi përpjekjet e qarkut dhe partnerëve të tjerë.

Afati kohor	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016					
Masat	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
C. Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura																														
1. Percaktimi i zonave te biznesit dhe infrastruktures perkatese																														
1.1. Studim fizibiliteti per zonimin																														
1.2. Zonim ne planet hapesine																														
1.3. Pergatitja e projekteve te infrastruktures																														
1.4. Zbatimi i projekteve te infrastruktures te lidhura me zonat e biznesit																														
1.5. Pergatitja e projekteve per infrastrukturen lokale (rruge, sipërfaqe te gjelberta, stacione autobusi, parkingje, rruge per bicikleta)																														
1.6. Zbatimi i projekteve te infrastruktures lokale																														
1.7. Mbushja e zonave te biznesit																														
1.8. Vleresimi i rezultateve dhe impakteve																														

Shembuj projektesh:

- Mbjellja e pemëve në ambientet publike
- Shëtitorja e Shëngjinit
- Vende parkimi në Lezhë dhe Shëngjin
- Projekte për rrugë dhe ura këmbësore në zonat turistike me materiale tradicionale të vendit
- Studimi kompleks i pikave kryesore turistike, si Kroji i Bardhë, Bjeshka e Oroshit, etj.

5.3.2. One stop shop

Vendosja në efikasitet të plotë e sistemit "One Stop Shop" si një masë me ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e klimës së biznesit është një nga prioritetet e qarkut në fushën e zhvillimit ekonomik. Procesi për zbatimin e kësaj mase do të jetë i vazhdueshëm dhe gjithashtu objekt i vlerësimit të efikasitetit nëpërmjet indikatorëve përkatës.

Afati kohor	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016					
Masat	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
C. Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura																														
2. One stop shop																														
2.1. Bashkëpunimi me partnere private (banka, institute sigurimesh) dhe autoritete shtetërore per te strukturuar projektin																														
2.2. Pergatitja e planit te biznesit per One stop shop																														
2.3. Aplikimi per financim ne fonde kombetare dhe te tjera																														
2.4. Punime ndertimore, blerja e paisjeve																														
2.5. Venia ne pune e 'One stop shop'																														
2.6. Vleresimi i rezultateve dhe impakteve																														

Shembuj projektesh:

- Blerje e paisjeve për One stop shop
- Inkubator shërbimesh për NVM

5.4. Mjedisi dhe Energjia

Duke pasur parasysh burimet e rëndësishme natyrore, potencialin për zhvillimin e sektorit energjetik dhe ndikimin e ndërsjellë me fusha të tjera prioritare, Mjedisi dhe Energjia do të jenë dy sektorë të cilët do të kenë vëmendjen e aktorëve rajonalë, jo vetëm në periudhën afatmesme,

por edhe përtej saj. Komplexiteti i tyre, por veçanërisht niveli i lartë i investimeve të nevojshme (mjedisi për shembull është një nga kapituj me kosto më të lartë të përafrimit me BE), do të bëjë që aktorët rajonalë të orientohen drejt shfrytëzimit të mundësive të brendshme, kombëtare dhe të atyre të asistencës evropiane.

5.4.1. Menaxhimi i vizitoreve ne zonat e mbrojtura

Kujdesi për përmirësimin e situatës dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura është një prioritet i cili është në fokus të vëmendjes, njëherësh me mundësitë që ofrojnë këto pasuri natyrore në rajon si pika atraktive të tij.

Afati kohor	2010					2011				2012				2013				2014				2015				2016				
Masat	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
D. Mjedisi dhe Energjia																														
1. Menaxhimi i vizitoreve ne zonat e mbrojtura																														
1.1. Përcaktimi i zonave lokale për menaxhim																														
1.2. Hartimi i planeve për zonat e mbrojtura																														
1.3. Zbatimi i planeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike																														
1.4. Aplikimi për fonde për përgatitjen e planeve të menaxhimit																														
1.5. Zbatimi i planeve të menaxhimit																														
1.6. Aplikimi për projekte të vogla për menaxhimin e zonave																														
1.7. Zbatimi i projekteve																														
1.8. Vlerësimi i rezultateve dhe impakteve																														

Shembuj projektësh:

- Menaxhimi i kalasë së Lezhës
- Menaxhimi i vizitorëve Kune-Vain
- Menaxhimi i vizitorëve Patok - Fushë Kuqe
- Menaxhimi i vizitorëve Bërzanë
- Menaxhimi i vizitorëve Bjeshka e Oroshit
- Projekte për mbrojtjen e zones bregdetare nga erozioni dhe përmbytjet nepermjet përdorimit të materialeve tradicionale

5.4.2. Planifikimi dhe zbatimi i infrastrukturës mjedisore

Kjo masë konkrete fokusohet pikërisht tek një nga fenomenet kryesore që shoqërojnë ritmet e larta të zhvillimit ekonomik dhe social: pasojat mjedisore. Duke synuar të ruajnë një ekuilibër avantazhues për të dy prioritetet (zhvillimi dhe mjedisi), aktorët rajonalë synojnë zhvillimin e sistemeve efikase mbrojtëse dhe parandaluese të fenomeneve negative.

Afati kohor	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016					
Masat	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
D. Mjedisi dhe Energjia																														
2. Planifikimi dhe zbatim i infrastruktures mejdimore																														
2.1. Analize e mangesive dhe pergatija e planit te zbatimit (direktivat e BE)																														
2.2. Plani per utesjellesat dhe pergatija e projekteve																														
2.3. Plani per ujerat e bardha dhe pergatija e projekteve																														
2.4. Plani per trajtimin e ujrave te zeza dhe pergatija e projekteve																														
2.5. Menaxhimi i mbetjeve dhe pergatija e projekteve																														
2.6. Plani per Ngrohjen dhe pergatija e projekteve																														
2.7. Aplikimi per financimin e utesjellesave																														
2.8. Aplikimi per financimin e ujrave te bardha																														
2.9. Aplikimi per financimin e ujrave te zeza																														
2.10. Aplikimi per financimin e menaxhimit te mbetjeve																														
2.11. Aplikimi per financimin e sistemit te ngrohjes																														
2.12. Zbatimi i projekteve te utesjellesave																														
2.13. Zbatimi i projekteve te ujrave te bardha																														
2.14. Zbatimi i projekteve te zeza																														
2.15. Zbatimi i projekteve te menaxhimit te mbetjeve																														
2.16. Zbatimi i projekteve per Ngrohjen																														
2.17. Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i masave ne lidhje me cilesine e ajrit ne zonat urbane dhe ato industriale																														
2.18. Vleresimi i rezultateve dhe impakteve																														

Shembuj projektsh:

- Heqja e mbetjeve kimike në rajon (pastrimi i zonave të ndotura)
- Vend për djegien e mbetjeve spitalore

5.4.3. Projekte energjitike për të ardhmen

Një nga përparësitë kryesore të qarkut Lezhë janë edhe potencialet e konsiderueshme dhe strategjike për zhvillimin e sektorit energjetik dhe veçanërisht të energjisë së rinovueshme. Partnerët rajonalë do të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e hapave konkretë në bashkërendim me projektet dhe strategjitë kombëtare në këtë sektor.

Afati kohor	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016					
Masat	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
D. Mjedisi dhe Energjia																														
3. Projekte energjitike per te ardhmen																														
3.1. analize e mundesive dhe studime fizibiliteti																														
3.2. Hapesirat per koncesione																														
3.3. Tenderat per koncesionet dhe kontraktimi																														

Shembuj projektsh:

- Përgatitja për identifikimin dhe fizibilitetin e zonave për shfrytëzimin e energjisë së erës

5.5. Menaxhimi rajonal, konteksti i partneriteteve brenda dhe nder-rajonale & qeverisja e orientuar drejt qytetarit

E fundit, por sigurisht jo për nga rëndësia, një vëmendje të veçantë do të marrë edhe menaxhimi rajonal si një nga komponentët thelbësorë për suksesin (rezultatet) dhe efikasitetin (krahasuar me koston) e zbatimit të Konceptit të Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë. Përmirësimi dhe konsolidimi i bashkërendimit të përpjekjeve dhe ndarjes së përgjegjësiive do të synohet të

përfshijnë jo vetëm kapacitetet dhe resurset e brendshme të rajonit, por gjithashtu edhe aktorët e tjerë të rëndësishëm në nivel kombëtar. Në këtë kontekst, masat zbatuese fillojnë menjëherë pas miratimit të Konceptit dhe prioritetet do të mbeten në qendër të vëmendjes në vazhdimësi. Nga ana tjetër, bashkepunimi me njesite e qeverisjes vendore në territorin e qarkut, si edhe vete Keshilli i Qarkut do të prioritetizojnë përfaqësimin e tyre ndaj një qeverisjeje të orientuar drejt qytetarit.

Afati kohor	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016		
	8	9	10	11	12	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	2016	
Masat																											
E. Menaxhimi rajonal																											
1. Bashkepunimi me bashkitë dhe komunat lokale																											
2. Bashkepunimi me nivelin kombëtar																											
3. Bashkepunimi me donatore dhe me burime të tjera financimi																											
4. Përgatitja e projekteve																											
5. Vlerësimi i rezultateve dhe impakteve																											
6. Programimi																											
7. Promovimi i rezultateve																											

Shembuj projektësh:

- Modernizimi i sistemit të mbledhjes së taksave
- Trajnim i menaxherëve rajonalë
- Koordinimi i përgatitjes së projekteve me bashkitë/komunat
- Krijimi i Agjencisë së Zhvillimit Rajonal
- Ngritje kapacitetesh për qeverisjen gjithë-përfshirëse
- Ndergjegjësim i qytetarëve për rolin dhe përfshirjen e tyre në qeverisje & proceset politike-bërëse lokale e rajonale

ARDHMËRIA

Zbatimi i Konceptit të Zhvillimit Rajonal

“Gjithëpërfshirës” dhe “ndërsektorial” janë ndoshta dy nga karakteristikat më të zakonshme e gjithashtu më thelbësore, kur sillen prova mbi qasjen e shoqërive të zhvilluara ndaj kuadrit të politikave zhvillimore si një instrument për t’u përballur me sfidat bashkëkohore të lidhura me zhvillimin socio-ekonomik brenda një rajoni të dhënë, si dhe pabarazive ndërmjet rajoneve në kontekstin kombëtar, evropian, apo global. Kjo është një përpjekje e vazhdueshme dhe ndërsektoriale që merr në konsideratë dhe ndikon në shumë fusha ose sektorë, të cilët së bashku kontribuojnë për të zhvilluar një standard jetese për qytetarët, një mjedis biznesi tërheqës për sektorin privat, një sistem qeverisjeje të orientuar drejt qytetarëve dhe një ndërveprim gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve të interesuar dhe rrjeteve të tyre që ndajnë bashkërisht vlera e burime për të arritur objektivat e përbashkëta e për t’u përballur me sfidat e përbashkëta. Është një kuadër gjithëpërfshirës që mbështetet në partneritete dhe “ushqim” nga një varg i gjatë aktorësh kyç – individë, grupe komunitare, grupe interesi, organe publike e private ose rrjetet e tyre, aktorë lokalë, rajonalë, ose kombëtarë, faktorë të brendshëm ose të jashtëm, etj.. Zhvillimi rajonal është një çështje që i përket secilit e prandaj ai nuk mund të qëndrojë si e drejtë e veçantë e një aktori të vetëm. As nuk mund të realizohet nga një rrjet i copëzuar që dështon në përfshirjen e aktorëve kyç dhe në caktimin e rolit të duhur për secilin prej tyre.

Nga perspektiva rajonale në kontekstin shqiptar, qarqet në Shqipëri nuk kanë kompetenca zbatuese të njohura nga legjislacioni në fuqi, ndërkohë që komunitetet lokale kanë burime dhe përgjegjësi të kufizuara. Ndaj zbatimi i planeve të zhvillimit rajonal përmbledhet kryesisht në funksionet koordinuese dhe promovuese. Kjo kërkon aftësi në përgatitjen e projekt propozimeve të mira dhe aftësi në prezantimin e tyre para organizatave të duhura që do të mund të ndihmojnë në zbatim.

Zbatimi i projekteve do të jetë i kënaqshëm po aq sa niveli i aftësisë së partnerit më të dobët. Dhe kjo na sjell tek bashkëpunimi midis komuniteteve lokale dhe këshillit të qarkut. Qarku do të jetë në një pozitë më të mirë në promovimin e projekteve nëse këto janë hartuar për zona më të mëdha (nganjëherë edhe për të gjithë territorin e qarkut), pasi këto kanë mundësi më të mëdha për të pasur ndikim tek grupe më të gjera të synuara.

Ky është funksioni i qarkut. Të organizojë dhe mbështesë përgatitjen e projekteve rajonale të cilat kanë impakt tek grupe më të mëdha dhe janë të afta të rriten në mënyrë të qëndrueshme dhe të zhvillohen më tej në iniciativa të reja.

Qarku do të organizojë një grup njerëzish (menaxhim rajonal) të cilët do të përqendrohen tek pikat më të dobëta të zhvillimit të sotshëm rajonal: kapacitete të afta, me dije dhe fonde. Ky grup do të duhet të ketë mbështetjen e sektorëve të ndryshëm – nga administrata deri tek biznesi.

Kuadri zbatues

Komunitetet lokale dhe qarku do të shfrytëzojnë një strukturë të përbashkët – këshillin e qarkut për të diskutuar dhe për të vendosur në lidhje me projekte rajonale prioritare, si edhe për të mbështetur përgatitjen e tyre. Grupi i menaxhimit rajonal do të jetë përgjegjës për përgatitjen e këtyre projekteve me mbështetjen e biznesit dhe shoqërisë akademike.

Grupi i menaxhimit rajonal do të fokusohet tek:


- Burimet e mundshme dhe të pritshme të financimit dhe shpërndarja e informacionit tek partnerët e zhvillimit rajonalë;
- Praktikant e hartimit të projekteve dhe trajnimi i partnerëve në hartimin dhe zbatimin e projekteve;
- Monitorimi dhe procedurat e raportimit tek projektet dhe ndikimi i tyre në mënyrë që t'i raportohet Qarkut dhe partnerëve të tjerë rajonalë në lidhje me zhvillimin e rajonit;
- Koordinimi i projekteve të tjera në mënyrë që të lehtësohet dhe të orientohet drejt ndikimit bashkëpunimi midis partnerëve;
- Nevojat për trajnime të partnerëve të zhvillimit rajonal për të organizuar rritjen e tyre.

Çdo organizatë zbatuese e projekteve do të mbështetet nga Këshilli i Qarkut dhe grupi i menaxhimit rajonal për të arritur rezultate më të mira dhe ndikim më të gjerë në rajon. Kjo do të pasohet nga më shumë projekte të hartuara dhe të zbatuara.

Grupi i menaxhimit rajonal në vitet e para do të fokusohet tek përgatitja e projekteve dhe aplikimi për to tek donatorë të ndryshëm, çka do të ndihmojë qarkun të njohë më mirë procedurat dhe të përmirësojë aftësitë për menaxhimin e projekteve. Më vonë, përgatitja e projekteve do të kalojë tek partnerët e tjerë dhe grupi i menaxhimit rajonal do të marrë përsipër koordinimin dhe monitorimin për të ekuilibruar projektet dhe zhvillimin në të gjithë rajonin.

Financimi

Qarku nuk disponon fonde të mjaftueshme për zbatimin e të gjithë konceptit të zhvillimit rajonal dhe projekteve të propozuara. Kjo është arsyeja e renditjes së prioritetëve – fillimisht në përgatitjen e projekteve që do të ndihmojnë në përgatitjen e projekt-ideve më të mëdha me dokumentacion të plotë. Më vonë kjo do të ndihmojë qarkun të tërheqë më shumë fonde dhe të zbatojë projektet hap pas hapi.



Kostot janë përllogaritur në bazë të vlerësimeve të përafërta dhe mund të ndryshojnë.

Përgatitjet për rolin fillestar të fazës së përgatitjes së projekteve do t'i kushtojnë qarkut rreth 1.4 milion EUR. Ky fond mund të sigurohet nga donatorë dhe programe të ndihmës. Për ta arritur këtë, Qarku do të duhet të vendosë në dispozicion një financim të tijin, ashtu si edhe komunitetet

lokale të cilat do të duhet të shtojnë fonde për të bashkëfinancuar këto kosto. Kostoja tjetër përfshin zbatimin e projekteve me një shumë prej rreth 18 milion EUR. Kjo është një shumë e madhe e cila duhet të sigurohet nga burime të ndryshme nga fonde lokale dhe rajonale (taksa, tarifa, grupe shërbimesh dhe investimesh nga kompanitë e shërbimeve lokale dhe rajonale), ndërsa pjesa tjetër e fondeve mund të ofrohen nga Bashkimi Evropian dhe programet e tjera të ndihmës. Kostot operationale të projektit do të duhet të mbulohen nga të ardhurat e gjeneruara nga projektet e hartuara.

Bashkëpunimi me donatorë të tjerë

Koncepti i Zhvillimit Rajonal imponon marrjen e disa vendimeve të rëndësishme të Qarkut Lezhë. Ndërkohë ka disa procese shtesë po aq të rëndësishme, të cilat duhen zbatuar dhe dokumentuar.

GTZ ka mbështetur qarkun për zhvillimin e vizionit, objektivave dhe masave, ndërsa donatorët e tjerë mund të ndihmojnë në aktivitetet e ardhshme, duke mbështetur përgatitjen e një Vlerësimi Strategjik të Konceptit, duke ndihmuar qarkun në përgatitjen e projekteve, organizimin e proceseve të tjera pjesëmarrëse, ose duke zhvilluar një sistem të monitorimit të arritjeve.

Mbështetja më e rëndësishme në këtë fazë është ndihma që qarku të hartojë projekte për aktivitetet e ardhshme dhe zbatimin. Kjo mund të bëhet nëpërmjet trajnimit ose mbështetjes direkte në hartimin e projekteve, ndërkohë që mbështetja financiare për zbatimin e projekteve do të jetë gjithashtu mëse e mirëpritur.

SHTOJCA

Shtojca I. Lista e dokumenteve dhe planeve strategjike

A	Konceptet kombëtare
A 1	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013
A 2	Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rural të Shqipërisë (SZHRNSH) 2007-2013
A 3	Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal (SNZHR)
A 4	Misioni i TAIEX-it për Politikën e Zhvillimit Rajonal
B	Konceptet rajonale
B 1	Tendencat Ekonomike dhe Sociale në Shqipërinë e Veriut: Analiza Ex post-/ SWOT
C	Konceptet ndërrajonale
C 1	Liçeni i Shkodrës: Koncepti për Zhvillimin Ndërsektorial – një perspektivë hapësinore
C 2	Plani Strategjik i Veprimit (PSZH) për Liçenin e Shkodrës - Shqipëri dhe Mal i Zi
D	Konceptet Ndërrajonale
D 1	Plani Rajonal për Shkodrën-Lezhën (2005-2020) ('EPTISA')
D 2	Plan Veprimi Rajonal Mjedisor Lumi i Drinit - Delta Shkodër/ Lezhë
E	Konceptet e Qarkut
E 1	Strategjia e Zhvillimit Rajonal për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Shkodër
E 2	Strategjia e Zhvillimit Rajonal për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Lezhë
F	Konceptet komunale/bashkiake
F 1	Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik 2005-2015 i Bashkisë së Shkodrës
F 2	Plani Strategjik Ekonomik i Bashkisë së Lezhës
F 3	Planet e Zhvillimit Lokal (PZHL) për Bashkitë në Shqipërinë e veriut <ul style="list-style-type: none">▫ Bashkia e Pukës▫ Bashkia e Koplikut▫ Bashkia e Dajçit▫ Bashkia e Gurit të Zi▫ Bashkia e Vaut të Dejës▫ Bashkia e Fushë Arrësit▫ Komuna e Velipojës▫ Velipoja

Shtojca II. Objektivat, masat zbatuese, institucionet pergjegjese dhe kostot

OBJETKIVI	MASAT ZBATUESE	INSTITUCIONI PERGJEGJES	FINANCIMI (EUR) ³	FINANCIMI TOTAL PER OBJEKTIVIN (EUR)
<p>Objetkivi 1 <i>Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në rryt me kapacitete më të mëdha industriale</i></p>	Mbështetje e koordinuar për bizneset e vogla bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit - Drejtoria Rajonale e Bujqesise e Ushqimit - Keshilli i Qarkut Lezhe - Shoqatat e Fermereve Lezhe - Dhoma e Tregetise Lezhe 	1.081.250	1.376.200
	Marka Rajonale	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit - Drejtoria Rajonale e Bujqesise e Ushqimit Lezhe - Keshilli i Qarkut Lezhe - Dhoma e Tregetise Lezhe 	97.000	
	Edukimi në bujqësi, pylltari dhe peshkim	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave - Ministria e Arsimit - Drejtoria Rajonale e Bujqesise e Ushqimit Lezhe - Drejtoria Rajonale Arsimore 	197.950	

³ Kostot e dhena jane indicative per nje periudhe 5 vjecare.

		Lezhe - Agjensia Rajonale e Mjedisit - Shoqata e Fermereve Lezhe - Shoqata e Pyjeve komunale Lezhe - Shoqata e Peshkimit Lezhe		
Objekivi 2 <i>Shërbime publike cilësore në fushën e arsimit dhe kulturës të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku, prezente në të gjithë territorin e qarkut dhe veçanërisht për grupet e ndryshme sociale</i>	Zhvillimi i shërbimeve sociale në komunitetet lokale	- Ministria e Punës Ceshjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta - Inspektoriati i Rajonal i Shërbimit Social Lezhe - Njesite vendore të Qarkut Lezhe	584.500	1.671.000
	Zhvillimi i shërbimeve të edukimit dhe të trajnimit profesional në qendrat më të rëndësishme të rajonit	- Ministria e punës Ceshjeve sociale dhe shanseve të barabarta - Njesite vendore (Bashkite qender rrethi)	47.500	
	Zhvillimi i produkteve turistike duke u mbështetur në vlerat e trashëgimisë kulturore	- Ministria e Kulturës, Turizmit Rinisë dhe Sporteve - Drejtoria Rajonale e Turizmit - Njesite Vendore të Qarkut Lezhe - Dhoma e Tregëtisë Lezhe - Agjensite Turistike	913.500	
	Qendra rajonale e rrjetimit (networking)	- Njesite Vendore të Qarkut Lezhe - Biznesi	125.500	
Objekivi 3 <i>Zhvillimi i sektorit privat i</i>	Përcaktimi i zonave të biznesit dhe infrastrukturës përkatëse	- Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës - Keshilli i Qarkut Lezhe	7.080.500	7.465.000

<i>mbështetur nga organizimi dhe promovimi i bashkëpunimit të biznesit, si edhe nga koordinimi i faktorëve të ndryshëm nxitës në nivel qarku dhe kombëtar</i>		- Njesite Vendore Lezhe - Dhoma e Tregetise Lezhe		
	One stop shop	- Njesite Vendore te Qarkut Lezhe - Dhoma e Tregetise - Shoqatat e biznesit	384.500	
Objekivi 4 <i>Përmirësimi i infrastrukturës si një kusht për përmirësimin e mundësive të jetës social-ekonomike dhe si një faktor nxitës për koordinimin me sektorë të tjerë si ai energjetik</i>	Menaxhimi i vizitoreve ne zonat e mbrojtura	- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave - Drejtorite e pyjeve dhe kullotave ne rrethe - Agjensia Rajonale e Mjedisit e Qarkut Lezhe - Njesite vendore te Qarkut Lezhe	92.500	7.398.500
	Planifikimi dhe zbatimi i infrastrukturës mjedisore	-Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave -Keshilli i Qarkut Lezhe - Njesite vendore te Qarkut Lezhe - Agjensia Rajonale e Mjedisit - Shoqatat mjedisit	7.105.500	
	Projekte energjitike për të ardhmen	-Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes - Keshilli i Qarkut Lezhe - Njesite vendore te Qarkut Lezhe - Biznesi	200.500	
Objekivi 5 <i>Konsolidimi i një marrëdhënie pozitive, të hapur dhe ndihmuese për komunitetin e banorëve të qarkut</i>	Menaxhimi rajonal, konteksti i partneriteteve brenda dhe nder-rajonale & qeverisja e orientuar drejt qytetarit	- Keshilli i Qarkut Lezhe - Keshilli i Qarkut Shkoder - Njesite vendore te Qarkut Lezhe - Shoqeria Civile	211.600	211.600
KOSTO TOTALE E ZBATIMIT				Perafersisht 18 milion EUR

